



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 469 Prot

Datë 08/02 2019

**VENDIM**

Nr. 79 , Datë 06.02 .2019

**“PËR  
MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE NË ZBATIM TË VKM-ve TË PAKETËS  
STUDENTORE”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar me VKM-në nr. 698, datë 21.11.2018, nr. 779, datë 26.12.2018; VKM nr. 778, datë 26.12.2018 “ për një ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, të këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve , në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë “, të ndryshuar; VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programme të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”; VKM-së nr. 784, datë 26.12.2018 “ Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 Të këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fodi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer , studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, Bordi i Administrimit ,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas pasqyrës nr.1 bashkëlidhur .
2. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas pasqyrës nr.2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë (mesatare 9-10) që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas pasqyrës nr.3 bashkëlidhur.
4. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të dytë me kohë të plotë që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas pasqyrës nr.4 bashkëlidhur.

5. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë (mesatare 9-10) që përfitojnë trajtimin me bursë nga fodi i mbështetjes studentore sipas pasqyrës nr.5 bashkëlidhur.
6. Në listat emërore të studentëve sipas përcaktimeve në pikën nr. 1 të këtij vendimi mungon informacioni nga sekretaritetë mësimore për Fakultetin e Historisë –Filologjisë .
7. Në listat emërore të studentëve sipas përcaktimeve në pikën nr.1; 3; 4; 5; të këtij vendimi mungon informacioni nga sekretaritetë mësimorë për Fakultetin e Drejtësisë.
8. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në buxhetin e vitit 2019.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij për vitin akademik 2018-2019.
10. Ky vendim t'i njoftohet AKFAL-it, MASR-së, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universtitetit të Tiranës për vitin 2019, sipas pasqyrës nr.6 bashkëlidhur.

**KRYETARË**

**Adela KARAPIC**

